

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-202/15**

**Prishtinë,  
24 Janar 2018**

Në çështjen juridike të:

**S. S.**

**Pala ankuese**

Kundër

**M. M.**

**Pala Përgjegjëse**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islam, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/236/2014 të datës 30 Prill 2014 (lënda e regjistruar me numrin KPA91748), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 24 Janar 2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/236/2014, të datës 30 Prill 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numrin KPA91748.
2. Prishet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/236/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA91748.
3. Bazuar në nenin 198.1 të Ligjit Nr.03/L006 të Procedurës Kontestimore, kërkesa e S. S. me numrin KPA91748 hedhet për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.

### Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 16 Tetor 2006, S. S. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku në emër të atit M.S. kërkon vërtetimin të drejtën pronësore mbi disa ngastra kadastrale në vendin e quajtur “Karagačko Polje”, midis tjerash edhe ngastra objekt i kërkesës me numër 5656/4 me sipërfaqe prej 0.04.39 h, komuna kadastrale Pejë (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Sipas palës përgjegjëse në ankesë, humbja e posedimit mbi pronën e kërkuar kishte ndodhur në Qershor 1999 si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese bashkë me kërkesën, kishte dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
  - Kopje e fletës poseduese Nr.4674 lëshuar nga Komuna Kadastrale e Pejës me 10 Shtator 1998 në të cilën figuron se prona e kërkuar është e evidentuar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës M. S,
  - Certifikatë lindje lëshuar nga Komuna e Pejës me 30 Qershor 1976 që dëshmon se S. S. është i biri i M,
  - Autorizim i dhënë nga M. S. për palën ankuese i certifikuar në Gjykatën Komunale në Užice me numër Ov.Br.1316/8 i datës 7 Mars 2008,
  - Certifikata vdekje e lëshuar nga Komuna e Užicës me 10 Gusht 2010 që dëshmon se M. S. ka ndërruar jetë me 5 Gusht 2009 në Užice,
  - Fletë poseduese lëshuar nga Drejtoria e kadastrit e Pejës me 10 Mars 1987 që dëshmon se prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të gjyshit të palës ankuese A. S.
  - Fletë poseduese lëshuar nga administrata e UNMIK-ut , Drejtoria e kadastrit e Pejës me 30 Tetor 2006 që dëshmon se prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të gjyshit të palës ankuese A. S.;
  - Kontratë e shitblerjes e lidhur në mes të blerësit A. S. dhe familjes L. me 9 Mars 1965 dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë me numër 1704/1965 datë 25 Dhjetor 1965.
3. Më 17 Tetor 2012, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë identifikimin e pronës së kërkuar duke e vendosur një shenjë në pronën e kërkuar, që rezultoi të ishte një pemishte e zënë nga persona të panjohur të cilët nuk ishin prezent në momentin e vizitës së pronës.

4. M. M. (më tej “pala përgjegjëse në ankesë) nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes dhe deklaroi se pronën e kërkuar gjegjësisht ngastrën 5656/4 e kam në pronësi dhe posedim të papenguar që nga viti 1955 kur e kamë blerë.
  - Ai paraqiti Aktvendimin Trashëgimor Nr T.Nr.626/03 të datës 22 Nëntor 2006 me të cilin pas vdekjes së E. M. masa trashëgimorë përfshirë pronën e kërkuar trashëgohet nga pala përgjegjëse dhe S. M. lindur M.
  - Fletën poseduese numër 1894 lëshuar nga administrative e UNMIK-ut në Pejë me 16 Gusht 2002 në të cilën figuron se prona e kërkuar evidentohet në emër të babait të palës ankuese E. M. dhe se ngastra e përmendur ka sipërfaqe prej 0.92.94 ha me kulturë pemishte.
  - Dëshminë e historikut të ngastrave numër 01-3/33 datë 14 Qershor 2012 –Drejtoria për kadastër e komunës së Pejës jep kronologjinë e ndërrimeve kadastrale sa i përket ngastrës 5656/4
  - Deklarate noteriale e A. dhe A. L. që dëshmon se kur është shitur prona është përfshirë edhe ngastra 5656/4 dhe është blerë nga pala përgjegjëse bashkë me ngastrat tjera dhe se nuk e di pse ka mbetur e evidentuar në emër të A.S. por e di se familja e palës ankuese e kanë marrë në posedim të papenguar që nga viti 1955 ,
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte arritur të verifikonte pozitivisht dokumentet me të cilat pala ankuese mbështeste kërkesën e saj.
6. Më 18 Qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e vet KPCC/D/R/247/2014 vendosi që kërkesa të refuzohet pasi sipas arsyetimit në paragrafin 25 ku thuhet se “paraqitësi i kërkesë ka dështuar të paraqesë dëshmi dhe Sekretaria ekzekutive sipas detyrës zyrtare nuk ka mundur të gjejë asnjë provë në regjistrat publik që mbështesin pretendimet për të drejtë pronësore të palës ankuese për arsye se humbja e posedimit nuk lidhet me rrethanat e konfliktit të armatosur qe ka ndodhur në vitin 1998/99 por me tjetërsim të vullnetshëm të pronës.
7. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 29 Tetor 2014. Më 24 Nëntor 2014, pala ankuese kishte paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
8. Pala përgjegjëse e ka pranuar ankesën me 3 Gusht 2015 por nuk është përgjigjur në ankesë.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

9. Pala ankuese thekson se Vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore të së drejtës materiale dhe gjithashtu vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
10. Sipas palës ankuese, dokumentet e dorëzuara dëshmojnë se prona evidentohet në emër të gjyshit dhe me vonë të babait të tij dhe se nuk ka mundësi të kenë mbetur gabimisht të evidentuara edhe pse vetë konfirmon shitjen e pronës në komunikim telefonik (faqe 132).
11. Në fund të ankesës së tij pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të pranoj ankesën e tij dhe të prish vendimin e KKPK-së dhe çështjen të lëshoj një vendim të ri ku urdhëron kthimin e pronës palës ankuese.

#### **Arsyetimi ligjor:**

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

### Meritat e ankesës

13. Pas shqyrtimit të shkresave në dosje të lëndës, vendimit të kundërshtuar dhe pretendimeve të palës ankuese, në përputhje me nenin 194 të LPK-së, Gjykata Supreme gjeti se vendimi i KKPK-së duhet të anulohet jo për merita të ankesës por *ex officio* pasi që i njëjti kishte kundërthënë midis urdhrat dhe arsyetimit dhe kërkesa nuk bie në kuadër të juridiksionit të tij.
14. Bazuar në nenin 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079 KKPK-ja ka juridiksion për kërkesat për pronën e paluajtshme private dhe të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën private “humbja e posedimit e të cilave lidhet direkt me pasojat e konfliktit të armatosur ose rrethanave të lidhura me konfliktin që ka ndodhur në mes të 27 shkurtit të vitit 1998 dhe 20 Qershorit të vitit 1999”. Në qoftë se Komisioni konstaton se humbja e posedimit nuk është si pasojë e konfliktit ai e hedhe kërkesën sipas nenit 11.4(b) të Ligjit Nr. 03/L-079.
15. Për më tepër sipas nenit 2.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, në tekstin e mëtejme Urdhëresa Administrative (UA) “çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejtë të lidhura me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999 apo rrethanave që kanë rezultuar nga ai, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë.
16. Në rastin konkret pala ankuese pretendon se ka pronësi që dëshmohet me evidencën kadastrale por nuk mund të dëshmoi se ka pas posedim për arsye se me rastin e blerjes së ngastrave 5670 dhe 5671 nga Gjyshi i tij edhe pse janë përfshirë në dokumente kadastral sipas pohimit të pronarëve të parë nuk janë përfshirë në shitblerje dhe nuk janë marrë në posedim. Sipas deklaratave të Familjes M. toka është shitur mbi bazën e vijave ndarëse(mexhave) pa matje kadastrale.
17. Në shkresat e lëndës del se kur është pyetur nga Sekretaria ekzekutive me 1 Gusht 2008 paraqitësi i kërkesës, gjegjësisht babai i palës ankuese ka pohuar se prona në ngastrën 5656/4 është tjetërsuar para konfliktit.
18. KKPK-ja ka vendosur që ta refuzoi kërkesën me arsyetimin se prona e kërkuar ishte humbur jo si rezultat i konfliktit por si pasoi e disponimit të lirshëm të pronarit. Gjykata Supreme gjeti se vendimi i KKPK-së ka kundërthënë dhe se në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se kërkesa refuzohet kurse në versionin në gjuhën Serbe “kërkesa hedhet’.
19. Gjykata Supreme konstatoi se KKPK-ja mirë kishte arsyetuar kur kishte thënë se kërkesa nuk është në kompetencë të KKPK-së sepse posedimi nuk është humbur si pasojë e konfliktit apo rrethanave që lidhen me te por nuk ka vepruar në përputhje me ligjin kur ka urdhëruar që kërkesa të refuzohet. Prandaj sipas detyrës zyrtare vendimi i KKPK-së duhej prishur dhe kërkesa duhej heshtur në mungesë të kompetencës në përputhje me dispozitat e nenit 198.1 të të Ligjit nr. 03/L-079 dhe për shkaqet e cekura në nenin 3.1

20. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për poseduesit aktual e as që paraqet pengesë për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente për palët që e konsiderojnë të nevojshme.
21. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 198.1 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it**

**Shukri Sylejmani, gjyqtar**

**Timo Eljas Torkko, referent i EULEX-it**